

## Vendim nr. 159 datë 11.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 11.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 18 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ALTIN DANI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 753, datë 15.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1769, datë 04.07.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-2189, datë 19.12.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 18, 27, 32, pika 2, 42, 43, 131 shkronja “f” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 753, datë 15.03.2017, ka vendosur të deklarojë fajtor kërkuesin për veprat penale të vrasjes në rrethana cilësuese, mbetur në tentativë dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “ë”, 22 dhe 278/1 të Kodit Penal (KP) dhe ta dënnojë, në bashkim të dënimeve, me 16 vjet burgim.

2. Ndonëse kërkuesi dhe prokurori kanë paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1769, datë 04.07.2018. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2189, datë 19.12.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga ligji.

3. Në datën 03.05.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 15.05.2024.

### II

#### Pretendimet e kërkuesit

4. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

- 4.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar për kërkesat dhe parashtrimet që ai ka paraqitur provat e marra në seancë gjyqësore dhe faktin e dhunës së ushtruar ndaj tij.
- 4.2. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, e garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës, pasi gjykatat e zakonshme kanë anashkaluar provat e marra në seancë gjyqësore dhe vendimi i fajësisë nuk bazohet mbi provat e marra në procesin gjyqësor. Organi i akuzës nuk ka relatuar faktet se ndaj kërkuesit është ushtruar dhunë fizike dhe se qitja ishte jashtë vetratës së lokalit, ndaj qëllimi i tij ishte për të trembur të dëmtuarin. Kërkesa për marrjen e pamjeve filmike të kamerave të lokalit ku ka ndodhur ngjarja nuk është pranuar.
- 4.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi gjykata ka ndryshuar akuzën për të bashkëpandehurin tjetër në atë të moskallëzimit të krimit,

ndërsa për të jo, duke mbajtur dy standarde. Vendimi i fajësisë është rrjedhojë e një gjykimit të padrejtë të provave dhe fakteve.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuësit

5. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

6. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kundërshton procesin gjyqësor në të cilin është vendosur për akuzat penale ndaj tij, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

7. Po kështu, Kolegji vë në dukje se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar në formë dhe substancë pretendimet e parashtruara, ndaj, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ai ka përmbushur edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion*.

8. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, momenti i konstatimit të cenimit të së drejtës konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në çështjen konkrete, Kolegji konstaton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë

mban datën 19.12.2023 dhe është bërë i disponueshëm për palët nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të gjykatës në datën 26.02.2024. Duke mbajtur në konsideratë se ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 03.05.2024, pra brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

10. Në drejtim të legjitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përparaara ligjit, së drejtës për të mos u deklaruar fajtor në bazë të të dhënave të marra në mënyrë të paligjshme dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e standardit të arsyetimit, të garantuara nga nenet 18, 32, pika 2 dhe 42 të Kushtetutës. Në mënyrë të përmbledhur ai ka argumentuar se gjykatat e zakonshme kanë anashkaluar provat e marra; organi i akuzës dhe gjykatat nuk kanë arsyetuar për dhunën e ushtruar ndaj tij dhe se qëllimi ka qenë trembja e të dëmtuarit; gjykatat kanë ndryshuar akuzën për të bashkëpandehurin tjetër, kurse për të jo, gjë e cila ka sjellë që edhe vendimi i fajësisë të jetë rrjedhojë e një gjykimit të padrejtë të provave dhe fakteve.

11. Kolegji mbështetur në thelbin e argumenteve të paraqitura nga kërkuesi vëren se ato lidhen me vlerësimin e provave dhe fakteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Lidhur me këtë, Kolegji sjell në vëmendje jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës, sipas së cilës vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e provave në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, të cilat nuk kanë detyrimin të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Ndaj, nuk është detyrë e saj të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove, për sa kohë që gjykatat e zakonshme, në arsyetimin e vendimeve të tyre, e mbështesin fajësinë e kërkuetit edhe mbi bazën e disa provave të tjera (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 40, datë 22.09.2011; nr. 9, datë 28.04.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij, në thelb, kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

13. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.